



REPUBLIKA E KOSOVËS-REPUBLIC OF KOSOVO

KOMUNA - MUNICIPALITY

HANI I ELEZIT



Nr. 01/ 7273 /2024

Në bazë të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale, Nr. 03/L-040, neni 11, 24, 40, Ligjin për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë, Nr. 03/L-048, neni 20, Ligji mbi Financat e Pushtetit Lokal, Nr. 03/L-49, neni 2, Qarkorja Buxhetore 2025/01 me numër protokolli 1259/2024 e datës 15.05.2024 dhe Qarkorja Buxhetore 2025/02 me numër protokolli 2046/2024 e datës 15.08.2024, Kuvendi i Komunës Hani i Elezit në mbledhjen e mbajtur më datë 30.09.2024 merr këtë:

V E N D I M

PËR MIRATIMIN E BUXHETIT PËR VITIN 2025 DHE PARASHIKIMET BUXHETORE PËR VITET 2026-2027

1. Buxheti i përgjithshëm i Komunës Hani i Elezit për vitin 2025 është në shumë prej 3,615,457.00 €, ndërsa parashikimet buxhetore për vitin 2026 janë në shumë prej 3,789,234.00 € dhe për vitin 2027 në shumë prej 3,967,100.00 €.
2. Në strukturën e të hyrave të tërsishme buxhetore për vitin 2025 sipas pikës (1) të këtij vendimi, mjetet nga Grantet Qeveritare janë në shumë prej 3,275,738.00 € që shënojnë pjesëmarrje me 90.6% ndërsa nga Të Hyrat Vetanake Komunale në shumë prej 339,719.00 € apo 9.4 %.
3. Shpenzimet e përgjithshme për vitin 2025 sipas kategorive buxhetore parashikohen të jenë: për paga dhe shtesa në shumë prej 2,188,542.00 €, mallra dhe shërbime në shumë prej 584,500.00 €, shpenzime komunale në shumë prej 94,000.00 €, subvencione dhe transfere në shumë prej 143,000.00 € dhe shpenzime kapitale në shumë prej 605,415.00 €.
4. Pjesë përbërse e këtij vendimi janë edhe tabelat e buxhetit për vitet 2025-2027 (4.1, 4.2 dhe 4.3).
5. Ky vendim hynë në fuqi 15 ditë pas protokollimit të autoritetit mbikëqyrës dhe 7 ditë pas publikimit në ueb faqen zyrtare të Komunës.

Me këtë vendim njoftohen: Kryetari i Komunës,

- Drejtorët e Drejtorive,
- Ministria e Financave, Punëve dhe Transfereve,
- Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal dhe
- Arkivi i Komunës.

30.09.2024

Hani i Elezit



Kryesues i Kuvendit

Edrim Shkreta



01/ Nr.7618//2024

Në bazë të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale numër Nr.03/L-040 neni 11, 40, Rregulloren e Punës së Kuvendit të Komunës neni 15, Kuvendi i Komunës në mbledhjen e mbajtur me datë 30.09.2024 merr:

VENDIM

PËR MIRATIMIN E PLANIT TË PUNËS SË KUVENDIT TË KOMUNËS SË HANIT TË ELEZIT PËR VITIN 2025

1. Kuvendi i komunës miratoi vendimin për planin e punës së kuvendit të komunës së Hani të Elezit për vitin 2025.
2. Kuvendi i Komunës së Hani të Elezit për vitin 2025 planifikon t'i mbajë gjithsej dymbëdhjetë mbledhje të rregullta dhe çdo mbledhje të kuvendit i paraprin mbledhja e komitetit për politik dhe financa.
3. Mbledhjet e rregullta të Kuvendit të Komunës së Hani të Elezit, do të mbahen sipas periudhës kohore të paraqitura si në tabelë:

	Vendimet/Çështjet
JANAR 2025	<ul style="list-style-type: none">• Raporti financiar për vitin 2024.• Propozim vendimi për ndarjen e bursave për studentë për vitin akademik 2024-2025.• Plani i punës së këshillave të fshatrave për vitin 2025.• Informatë mbi veprimtarit e subjekteve afariste për vitin 2024.
SHKURT 2025	<ul style="list-style-type: none">• Raporti i punës së kryetarit të komunës për vitin 2024.• Raporti i punës së kuvendit të komunës për vitin 2024.• Propozim vendim për bartjen e të hyrave vetanake të pashpenzuar nga viti i kaluar në vitin aktual.• Raporti financiar për vitin 2024 i N.P.L "Pastrimi" sh.a.• Informatë mbi procesin e trajtimit të ndërtimeve pa leje dhe legalizimin e tyre
MARS 2025	<ul style="list-style-type: none">• Raporti i punës së komitetit për komunitete për vitin 2024.• Informatë për aktivitetet e këshillit komunal për siguri në bashkësi për vitin 2024.• Informatë për aktivitetet e këshillave të fshatrave të komunës së Hani të Elezit për vitin 2024.
PRILL 2025	<ul style="list-style-type: none">• Raporti financiar për periudhën Janar – Mars 2025.• Raporti periodik lidhur me progresin e zbatimit të rekomandimeve të auditorit .• Informatë për ndarjen e bursave.• Raporti financiar për periudhën Janar – Mars 2025 i N.P.L "Pastrimi" sh.a.

MAJ 2025	<ul style="list-style-type: none"> • Rishikimi i buxhetit të komunës për vitin 2025. • Informatë mbi mbrojtjen e mjedisit. • Shqyrtimi i Planit Zhvillimorë Komunal.
QERSHOR 2025	<ul style="list-style-type: none"> • Korniza afatmesme buxhetore 2026-2028. • Miratimi i Planit Zhvillimorë Komunal. • Propozim vendimi për themelimin e grupit punues për hartimin e planit të punës së Kuvendit të Komunës për vitin 2026.
KORRIK 2025	<ul style="list-style-type: none"> • Raporti financiar për periudhën Janar – Qershor 2025. • Raporti i auditorit të përgjithshëm për Komunën e Hanit të Elezit për vitin 2024. • Plani i Veprimit të Komunës së Hanit të Elezit për adresimin e rekomandimeve të raportit të auditimit 2024. • Informatë për aktivitetet e këshillit komunal për siguri në bashkësi për gjashtë mujorin e parë të vitit 2025. • Raporti për vlerësimin e performances së Komunës për vitin 2024. • Raportin financiar për periudhën Janar – Qershor 2025 i N.P.L “Pastrimi” sh.a. • Informatë për sektorin e emergjencave.
GUSHT 2025	<ul style="list-style-type: none"> • Raporti i punës së kryetarit të komunës për periudhën Janar - Qershor 2025. • Informatë mbi suksesin e arritur të nxënësve në SHFMU dhe SHML në fund të gjysmëvjetorit të dytë të vitit shkollor 2024-2025. • Shqyrtimi i rregullores për taksa komunale për vitin 2026. • Informatë për korrje shirjet.
SHTATOR 2025	<ul style="list-style-type: none"> • Buxheti i komunës për vitin 2026 dhe parashikimet buxhetore për vitin 2027-2028. • Miratimi i rregullores për taksa komunale për vitin 2026. • Plani i punës së kuvendit të komunës për vitin 2026. • Informatë mbi fillimin e vitit të ri shkollor 2025/2026.
TETOR 2025	<ul style="list-style-type: none"> • Raporti financiar për periudhën Janar – Shtator 2025. • Miratimi i Hartës Zonale të Komunës së Hanit të Elezit • Vendim për caktimin e normave tatimore për tatimin mbi pronën e paluajtshme për vitin 2026. • Plani i biznesit të N.P.L Pastrimi sh.a. për vitin 2026. • Raporti periodik lidhur me progresin e zbatimit të rekomandimeve të auditorit . • Raporti financiar për periudhën Janar – Shtator 2025 i N.P.L Pastrimi sh.a. • Informatë për çështjen e ujit. • Informatë për qendrën për punë sociale.
NËNTOR 2025	<ul style="list-style-type: none"> • Informatë për ndarjen e subvencioneve në bujqësi. • Informatë mbi gjendjen në shëndetësi.
DHJETOR 2025	<ul style="list-style-type: none"> • Plani i punës së ekzekutivit të komunës së Hanit të Elezit për vitin 2026. • Plani i punës së këshillit komunal për siguri në bashkësi për vitin 2026 • Plani i punës së komitetit për komunitete për vitin 2026.

4. Kuvendi i Komunës së Hanit të Elezit gjatë vitit 2025, mund të mbajë edhe mbledhje tjera të rregullta më shumë se minimumi i paraparë me aktet në fuqi. Të gjitha mbledhjet e rregullta do të mbahen vetëm ditëve të punës.
5. Të gjitha mbledhjet e rregullta të Kuvendit të Komunës do të jenë të hapura për qytetarë dhe përfaqësues të mediave publike. Nëse ndonjë mbledhje e rregullt apo pjesë e mbledhjes do të mbahet me dyer të mbyllura atëherë për këtë duhet të vendosë Kuvendi i Komunës. Nëse mbledhja mbahet me dyer të hapura në mbledhjet mund të marrin pjesë qytetarët e komunës dhe përfaqësues të mediave në përputhje me kushtet dhe mundësitë fizike.
6. Kuvendi i komunës mund të mbajë edhe mbledhje tjera, varësisht prej nevojave që paraqiten.
7. Njoftimet për mbledhje të kuvendit të komunës bëhen publike. Materialet për mbledhjet e rregullta të kuvendit të komunës iu dorëzohen të gjithë anëtarëve të kuvendit të komunës 7 ditë pune para mbajtjes së mbledhjes. Njoftimet dhe materiali i mbledhjes i dërgohet edhe Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal.
8. Plani i mbledhjeve të kuvendit, i përcaktuar si në pikën tre (3) të këtij vendimi, është orientues e nuk do të thotë se nuk pëson ndryshime.
9. Plani i mbledhjeve të kuvendit të komunës për vitin 2025, ka fuqi veprimi nga muaji Janar deri në muajin Dhjetorë të vitit 2025.
10. Ky vendim hynë në fuqi 15 ditë pas protokollimit të autoritetit mbikëqyrës dhe 7 ditë pas publikimit në ueb – faqen zyrtare të komunës.

Me këtë vendim njoftohen:

- Kryetari i Komunës,
- Drejtorët e Drejtorive,
- Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal dhe
- Arkivi i Komunës.

Hani i Elezit
Data: 30.09.2024

